

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Goal: UJË I PASTËR DHE KANALIZIME

Sigurimi i furnizimit dhe i menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë.

Target: 6.1

6.1 Deri në vitin 2030, të arrihet furnizimi i gjithanshëm dhe i barabartë me ujë të pijshëm, të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë

Instrumentet ndërkombëtare Nenet

Neni 14.2

Palët e Shteteve marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në zonat rurale në mënyrë që të sigurojnë, mbi bazën e barazisë së burrave dhe grave, që ata të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga zhvillimi rural dhe, veçanërisht, t'u sigurojnë grave të tilla e drejta:

- (a) Të marrë pjesë në shtjellimin dhe zbatimin e planifikimit të zhvillimit në të gjitha nivelet;
- (b) Të ketë akses në institucione adekuate të kujdesit shëndetësor, përfshirë informacionin, këshillimin dhe shërbimet në planifikimin e familjes;
- (c) Për të përfituar drejtpërdrejt nga programet e sigurimeve shoqërore;
- (d) Të marrë të gjitha llojet e trajnimeve dhe arsimimit, formale dhe joformale, përfshirë atë që lidhet me arsimimin funksional, si dhe, ndër të tjera, përfitimin e të gjitha shërbimeve të komunitetit dhe shtrirjes, me qëllim të rritjes së aftësive të tyre teknike;
- (e) Të organizojnë grupe të vetë-ndihmës dhe kooperativa në mënyrë që të sigurojnë qasje të barabartë në mundësi ekonomike përmes punësimit ose vetë-punësimit;
- (f) Të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e komunitetit;
- (g) Të ketë qasje në kredi dhe kredi bujqësore, lehtësirat e marketingut, teknologjinë e duhur dhe trajtimin e barabartë në tokën dhe reformën agrare, si dhe në skemat e rivendosjes së tokës;
- (h) Të gëzojnë kushte të përshtatshme jetese, veçanërisht në lidhje me strehimin, kanalizimet, furnizimin me energji elektrike dhe ujë, transportin dhe komunikimet.

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

Instrumentet ndërkombëtare Nenet

Neni 22

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Secili, si anëtar i shoqërisë, ka të drejtë sigurimi social dhe t' drejta t' domosdoshme ekonomike, sociale e kulturore për dinjitetin e tij dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit t' tij, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe burimet e çdo shteti.

Neni 24

Konventa për të Drejtat e Fëmijës
Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmije të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.
2. Shtetet Palë ndjekin zbatimin e plotë të kësaj të drejte dhe në veçanti marrin masat e duhura:

- (a) Për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmijërore;
- (b) Për t'u siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore dhe kujdesin për shëndetin, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor;
- (c) Për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të përdorimit, ndër të tjera, të teknikave lehtësisht të arritshme si dhe të sigurimit të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;
- (d) Për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;
- (e) Për të mundësuar që gjithë grupet shoqërore dhe në veçanti prindërit dhe fëmijët të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi dhe të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën dhe shëndoshjen e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve;
- (f) Për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues, këshillimin e prindërve, edukimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar.

3. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e efektshme dhe të nevojshme për të zhdukur praktikat tradicionale të dëmshme për shëndetin e fëmijëve.

4. Shtetet Palë marrin përsipër të nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, me qëllim që të sigurojnë gradualisht realizimin e plotë të së drejtës së njohur në këtë nen. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Ligjet

Nenet

LIGJI Nr. 04/L-
147 PËR
UJËRAT E
KOSOVËS
LIGJI Nr. 04/L-
147 PËR
UJËRAT E
KOSOVËS

Neni 6 para 1.11

Parimin e pjesëmarrjes së palëve të interesuara - organet kompetente janë të detyruara që të sigurojnë, që në procedurën për miratimin e dispozitave, dokumenteve strategjike, plan - programeve dhe vendimeve të marrin parasysh interesat e palëve të interesuara;

Neni 2

LIGJI Nr. 04/L-
147 PËR
UJËRAT E
KOSOVËS
LIGJI Nr. 04/L-
147 PËR
UJËRAT E
KOSOVËS

Me këtë ligj rregullohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me: ujërat sipërfaqësorë, liqenet, akumulimet, rezervuarët, burimet natyrore, ujërat nëntokësorë, tokat e lagëta, truallin buzë brigjeve të lumenjve, çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e tyre; përdorimin dhe shpërndarjen e ujërave, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujërave, mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë përmytjet, vërshimet, thatësitë, erozionin, objektet dhe infrastrukturën ujore, financimin e ujërave, si dhe kushtet, mënyrat dhe veprimet me të cilat mund të shfrytëzohet ose shkarkohen ujërat.